

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Enver Peci, kryetar, Emine Mustafa dhe Nesrin Lushta, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarve H.A., N.A., I.R., A.B., E.B., S.S., H.E., H.L., M.B., L.L. dhe S.H., për shkak të veprës penale organizimi dhe pjesëmarrja në grupe terroriste nga neni 143 par.2 të KPK, ndërsa I.R., S.H. dhe A.L., për shkak të veprave penale secili veç e veç mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK, duke vendosur përkitazi me kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë të paraqitur nga mbrojtësit e të dënuarve N.A., I.R., A.B., E.B. dhe H.E., kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore - DKR Prishtinë, Pkr.nr.263/2015 datë 29.04.2016 dhe aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - DKR, PAKR.nr.518/2016 datë 04.05.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me 18 dhjetor 2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pabazuara kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësve të të dënuarve N.A., I.R., E.B., H.E. dhe e të dënuarit A.B., të paraqitura kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore - DKR Prishtinë, Pkr.nr.263/2015 datë 29.04.2016 dhe aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - DKR, PAKR.nr.518/2016 datë 04.05.2017.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore - DKR Prishtinë, Pkr.nr.263/2015 datë 29.04.2016, të dënuarit H.A., N.A., I.R., A.B., E.B., S.S., H.E. dhe H.L., secili veç e veç janë shpallur fajtor për shkak të veprës penale organizimi dhe pjesëmarrja në grupe terroriste nga neni 143 par.2 të KPK, ndërsa L.L. dhe S.H., secili veç e veç për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK, dhe për këto vepra janë gjykuar: H.A., S.S., H.L.

dhe M.B., secili veç e veç me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) vitesh, në të cilat dënime u është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim H.A., prej 11.08.2014 gjerë më 04.09.2014 dhe në arrest shtëpiak nga data 04.09.2014 gjer më 13.10.2015, S.S., prej 11.08.2014 gjer më 01.07.2015 dhe në arrest shtëpiak nga 01.07.2015 gjerë më 18.01.2016 dhe në paraburgim nga data 18.01.2016 gjer më 29.04.2016, H.L., koha e kaluar në arrest shtëpiak prej 11.08.2014 gjerë me 01.06.2015 dhe M.B., prej 11.08.2014 gjer me 01.07.2015, në arrest shtëpiak nga data 01.07.2015 gjerë me 08.12.2015 dhe në paraburgim nga 08.12.2015 gjerë me 29.04.2016, A.B., me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tri) vite e 6 (gjashtë) muaj, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej 11.08.2014 gjer me 04.09.2014, N.A., me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) vite e 6 (gjashtë) muaj, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 11.08.2014 gjerë me 29.12.2014, në arrest shtëpiak nga data 29.12.2014 gjer me 12.11.2015 dhe në paraburgim nga 12.11.2015 gjerë me 29.04.2016, I.R, me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) vite, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga 11.08.2014 gjerë me 16.12.2014, në arrest shtëpiak nga 16.12.2014 gjerë me 13.07.2015 dhe në paraburgim nga data 13.07.2015 gjer me 29.04.2016, E.B., me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) vite duke i llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim nga 19.09.2014 gjer me 16.12.2014, në arrest shtëpiak nga data 16.12.2014 gjerë me 08.12.2015 dhe në paraburgim nga data 08.12.2015 gjerë me 29.04.2016, H.E., me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) vite e 6 (gjashtë) muaj, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej 11.08.2014 gjerë më 29.04.2016, L.L., me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në periudhën kohore prej 1 (një) viti nuk kryen vepër të re penale dhe S.H., me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajsh, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në periudhën kohore prej 1 (një) viti nuk kryen veprë të re penale, në të cilin i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 11.08.2014 gjer me 09.01.2015. Është shqiptuar edhe dënimi plotësues ndaj të dënuarit L.L., ashtu që i konfiskohet një pushkë gjysmë automatike me nr.serik.K-378895, një pushkë gjuetie e punuar me dorë me nr.serik.3216908, së bashku me fishek të kalibrave të ndryshëm ndërsa ndaj të dënuarit S.H., është konfiskuar pushka M-48 me mbishkrimin "Kraleovina Jugosllavia" modeli 1924 me nr.serik.265297. Janë detyruar që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguajnë shumën sipas llogarisë së gjykatës, ndërsa secili veç e veç në emër të paushallit gjyqësor shumën prej nga 100 €, të gjitha në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Me të njëjtin aktgjykim është refuzuar akuza ndaj të pandehurve Ibrahim R. dhe A.L., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK, sepse përfaqësuesi i akuzës ka heq dorë nga ndjekja penale. Është vendosur që të konfiskohet pushka M48 me nr.serik.2149 M167 kalibrit 7.9 mm, si dhe 76 copë fishek të kalibrit 7.9 mm.

Në procedurën ankimore, me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës-DKR, PAKR.nr.518/2016 datë 04.05.2017, janë refuzuar si të pabazuara ankesat e të dënuarve H.A., N.A., I.R., A.B., E.B., S.S., H.E., H.L., M.B. dhe ajo e Prokurorit të Shtetit, ndërsa aktgjykimi i shkallës së parë është vërtetuar. Aktgjykimi i shkallës së parë, sipas dispozitivit II. në pjesën refuzuese përkritazi me të dënuarin I.R. dhe A.L., L.L. dhe S.H., ka ngel i pandryshuar.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë kanë paraqitur:

-mbrojtësi i të dënuarit N.A., H.S., avokat nga P., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që aktgjykimet të anulohen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim ose të ndryshohen ashtu që i dënuari në mungesë provash të lirohet.;

-mbrojtësi i të dënuarit I.R., H.P., avokat nga P., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që aktgjykimet të anulohen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim ose të ndryshohen dhe i dënuari të lirohet nga akuza;

-i dënuari A.B., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të dispozitave të procedurës penale, shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që aktgjykimet të anulohen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim ose të ndryshohen dhe të lirohet nga akuza;

-mbrojtësi i të dënuarit E.B., A.Gj., avokat nga P., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që aktgjykimet të anulohen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe

-mbrojtësi i të dënuarit H.E., H.Zh., avokat nga P., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal me propozim që aktgjykimet të anulohen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim, ose të ndryshohen dhe i dënuari të lirohet nga akuza. Njëherësh ka propozuar që të shtyhet ekzekutimi i vendimit të formës së prerë.

Prokurori i Shtetit të Kosovës, me parashtresën KMLP.nr.154/2017 datë 12.09.2017, ka dhënë përgjigje në kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë, duke propozuar që të njëjtat të refuzohen si të pabazuara.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e çështjes në kuptim të nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPPK, dhe pas vlerësimit të pretendimeve nga kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë , konstatoi:

Kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk janë të bazuara.

Mbrojtësi i të dënuarit N.A., në kërkesë pretendon se aktgjykimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat konsistojnë në atë se në dispozitivin e aktgjykimit nuk janë përfshirë të gjitha të dhënat dhe rrethanat që përbëjnë figurën e veprës penale për të cilën i dënuari është shpallur fajtor, aktgjykimi bazohet në prova të papranueshme dhe të parëndësishme. Më pas theksohet se fotoalbumi i sendeve të gjetura dhe të konfiskuara nga i dënuari N., si të tilla janë të papranueshme, aktgjykimi po ashtu bazohet në shkresën e OKB-së në bazë të cilës fronti “Al-Nusra” është shpallur një nga grupet më të afërta me “Al Kaidën” (terroriste), që vepron në territorin e Sirisë si dhe në shkresat – Rezolutën e KS të OKB-së nr. 1922 (viti 2008), për të theksuar se kjo Rezolutë nuk ka fuqi të provës meqë nuk është ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Më pas në kërkesë potencohet se gjykata ka refuzuar që të nxjerr si provë vërtetimin e Kryqit të Kuq Ndërkombëtar (ICRC Gjenevë) të datës 22 tetor 2015 e cila vërteton se i dënuari është arrestuar nga autoritetet jordaneze më 8 shkurt 2013 dhe është vizituar nga ky Komitet i cili vërteton se i dënuari nuk ka qenë pjesëmarrës i grupeve terroriste. Theksohet se në arsyetimin e aktgjykimit nuk janë paraqitur arsye për çdo pikë të aktgjykimit, gjykata nuk ka paraqitur qartë se cilat fakte dhe për çfarë arsye i konsideron si të vërtetuara, në veçanti nuk janë vlerësuar provat kundërthënëse, mirëpo këto pretendime nuk i mbështet me ndonjë arsyetim të mirëfilltë. Në fund pretendon se për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, është bërë shkelja e ligjit penal. Kërkesës i ka bashkangjitur një shkresë në gjuhën arabe e përkthyer në shqip të datës 9.8.2017.

Mbrojtësi i të dënuarit I.R., lidhur me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale thekson se është shkelur dispozita e nenit 384 par.1 pika 1.12 lidhur me nenin 370 par.7 të KPPK, sepse dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm, kundërthënës me arsyetimin, në arsyetim nuk janë paraqit në mënyrë të qartë arsye se cilat fakte gjykata i ka konsideruar si të vërtetuara të cilat jo, provat nuk janë vlerësuar në pajtim me ligjin në veçanti ato kundërthënëse, më tej thekson se është shkelur dispozita e nenit 123 par.2 të KPPK, për faktin se sipas kësaj dispozite nuk mund të përdoret si provë e drejtpërdrejt në shqyrtimin gjyqësor i cili në shqyrtimin gjyqësor ka ndryshuar deklaratën e që deklarata e të dënuarit N. është marrë si provë e vetme fajësuese. Në kërkesë theksohet se sipas ligjit për ndalimin e bashkimit në konfliktet e armatosura jashtë territorit të Kosovës mund të shpallet fajtor pas 25 marsit 2015 kur ligji në fjalë është dekretuar.

I dënuari A.B., përkitazi me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale thekson se këto shkelje konsistojnë në atë se në aktgjykimin e shkallës së parë mungon arsyetimi se cilat fakte gjykata i ka konsideruar si të vërtetuara apo të pavërtetuara kur atë e ka shpallur fajtor, provat kundërthënëse nuk janë vlerësuar në pajtim me ligjin ndërsa në arsyetim nuk janë dhënë arsye për faktet vendimtare, kurse ato të dhëna janë të paqarta dhe kundërthënëse. Dispozitivi i aktgjykimit është i paqartë sepse nga përshkrimi i veprës penale del se nuk ekziston vepra penale për të cilën është shpallur fajtor. Sipas të dënuarit është shkelur dispozita e nenit 262 par.2 të KPPK, sepse është shpallur fajtor nga deklarata e dhënë nga vetë i pandehuri, më pas thotë se është shkelur dispozita e nenit 9 par.1 dhe 2 të KPK sepse është shkelur parimi i barazisë së palëve, meqë gjykata nuk ka pranuar propozimin e tij për dëgjimin e dëshmitarëve respektivisht policët hetues (të cilët i kanë premtuar se nuk do të jetë pjesë e akuzës). Në vazhdim, precizon se ka qenë në lajthim faktik, e më pas jep shpjegime rreth kësaj dhe qëllimit të tij të shkuarjes në Siri, për të theksuar se pasi ka arritur në formacionin “Al-Nusra” në ditën e pestë ka pa se ishte një gabim i madh dhe ka vendosur që të kthehet në shtëpi. Në vazhdim të kërkesës i dënuari gjerësisht i referohet gjendjes faktike duke shpjeguar qëllimin e shkuarjes së tij në Siri dhe në fund konkludon se bazuar në faktin se ka qenë në Siri me qëllim që t’i ndihmoj popullit sirian gjykata e ka shpallur fajtor dhe kështu është shkelur ligji penal në dëm të tij sepse me asnjë provë nuk janë vërtetuar veprimet e tij inkriminuese.

Mbrojtësi i të dënuarit E.B., pretendon se aktgjykimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 pika 1.12 të KPPK, sepse dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë është i pakuptueshëm edhe kundërthënës me brendinë e tij. Në aktgjykim nuk janë paraqitur arsye mbi faktet vendimtare, ekziston një kontradiktë në mes të asaj që paraqitet në arsyetimin e aktgjykimit dhe përmbajtjen e dokumenteve ose procesverbaleve. Aktgjykimi nuk është përpiluar në pajtim me nenin 270 par.7 të KPPK, mirëpo përveç citimit të dispozitës ligjore nuk specifikohen shkeljet konkrete por theksohet se gjykata e shkallës së parë aktgjykimin e mbështet në deklaratën e S.S. mirëpo, të njëjtën vetëm e citon kurse nuk jep vlerësimin e kësaj deklarate meqë i njëjti ka pranuar fajësinë i cili nuk ka deklaruar se me E. ka udhëtuar në Siri. Pra, aktgjykimi bazohet vetëm në supozime meqë gjykata nuk ka vlerësuar as mbrojtjen e të dënuarit E. në mënyrë të drejtë. Meqë, gjykata e shkallës së dytë nuk ka evituar shkeljet e potencuara, mbrojtësi thekson se edhe ky aktgjykim është i paligjshëm.

Mbrojtësi i të dënuarit H.E., në kërkesën e tij potencon se aktgjykimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 pika 1.12 e lidhur me nenin 370 par.6 dhe 7 të KPPK, të cilat konsistojnë në atë se nuk janë dhënë arsye për çdo pikë të aktakuzës. Në arsyetim janë dhënë vetëm përshkrimet e mbrojtjes së të dënuarit nga hetuesia dhe shqyrtimi gjyqësor. Mbrojtësi pretendon se në aktgjykimin e shkallës së parë vetëm ceket se i

dënuari ka ndryshuar mbrojtjen nga ajo e dhënë në hetuesi gjë që nuk është e vërtetë sepse vetëm janë dhënë sqarimet plotësuese të deklaratës së tij të dhënë në hetuesi. Në fakt mbrojtësi i të dënuarit, nuk e mohon faktin se i dënuari një herë ka qenë në Siri në fillim të vitit 2013 ku ka ndërmarrë aktivitetet në një grup të ushtarëve çlirimtarë të cilin e përkrah edhe bota demokratike madje edhe Kosova. Theksohet se mungon arsyetimi mbi zgjedhjen e çështjes juridike respektivisht se si gjykata vërtetohet se i dënuari ka marrë pjesë në aktivitetet terroriste, është e paqartë se si është vërtetuar se i njëjti ka bërë ushtrime ushtarake në ISIS, ndërsa nga ana tjetër i dënuari pohon se nuk ka qenë pjesë e këtij grupacioni por ka qenë pjesë e ushtrisë së lirë e cila nuk është shpallur terroriste, për të theksuar se nuk mund të ekzistojë vepra sepse element qenësor i veprës penale është veprimtaria në organizatën terroriste e që gjykata në rastin konkret është dashur që të aplikojë institutin “in dubio pro reo” dhe të dënuarin ta lirojë nga akuza.

Duke vlerësuar pretendimet e mbrojtësve të të dënuarve N.A., I.R., E.B., H.E. dhe të dënuarin A.B. lidhur me kundërthëniet në mes të dispozitivit dhe arsyetimit të aktgjykimit të shkallës së parë dhe se aktgjykimi nuk është përpiluar në pajtim me dispozitën e nenit 370 të KPPK, kjo Gjykatë konstaton se, ndonëse asnjëri nga mbrojtësit të të dënuarve si dhe i dënuari A.B., në kërkesat e tyre nuk kanë specifikuar të cilat janë ato paqartësitë dhe kundërthëniet konkrete në mes të dispozitivit dhe arsyetimit dhe ku qëndrojnë kundërthëniet të arsyetimit të aktgjykimit dhe shkresave të çështjes por vetëm parafrazojnë dispozitën ligjore prandaj, gjykata pretendimet në fjalë i refuzoi si të pabazuara në mbështetje të dispozitës së nenit 436 par.1 të KPPK, e cila dispozitë parashikon se me rastin e vendosjes mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, Gjykata Supreme e Kosovës kufizohet vetëm në verifikimin e shkeljeve ligjore në të cilat paraqitësi i kërkesës pretendon.

Megjithatë, kjo Gjykatë vlerëson se dispozitivat e aktgjykimit të shkallës së parë në raport me secilin të dënuar, janë të qartë dhe përmbajnë të gjitha të dhënat për kohën, vendin, mënyrën e kryerjes së veprave penale dhe të dhëna të tjera që paraqesin elementet qenësore të veprave të kryera penale. Në arsyetimin e të dy aktgjykimeve janë dhënë arsye ligjore për të gjitha pikat e aktgjykimit, në veçanti për tezën e mbrojtjes së të dënuarve, siç është paraqitur në faqen 30-33 të aktgjykimit të shkallës së parë respektivisht 13-14 të shkallës së dytë.

Vlen të theksohet se të dënuarit, secili veç e veç janë shpallur fajtor për shkak të veprës penale organizimi dhe pjesëmarrja në grupet terroriste nga neni 143 par. 2 të KPPK, pra të gjithë janë shpallur fajtor për veprimet konkrete, prandaj përkrahimi i veprimeve të tyre në dispozitiv nuk e bëjnë të njëjtin kundërthënës apo të paqartë.

Për faktet vendimtare janë dhënë arsye ligjore bazuar në vlerësimin e provave konform dispozitës së nenit 262 par. 2 të KPPK.

Kështu, në këtë çështje penale nuk ka qenë kontestuese se të dënuarit N.A., I.R., A.B. dhe H.E. në kohën kritike siç është përshkruar në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së parë kanë qenë në Siri, sikurse edhe fakti se të gjithë atje janë bashkangjitur formacionit terrorist “Al - Nusra”. Ndërsa, se i dënuari Enis po ashtu ka qenë në Siri është vërtetuar edhe nga deklarata e të dënuarit S.S. i cili në tërësi ka pranuar veprën penale. Ky i dënuar në polici më 05.11.2014 ka pohuar se të dënuarin E. e njeh si xhemat në xhami dhe me të kur herën e dytë ka shkuar në Siri, kanë udhëtuar së bashku me E., nga P. deri në H. e më pas ai ka vazhduar për në Siri dhe më nuk janë takuar. Nuk ka qenë kontestues fakti se në shtëpinë e të dënuarit N., janë gjetur dhe konfiskuar kartmonedhë me mbishkrimin “Central Bank Off Syria”, 28 letra me ngjyrë të zezë të prera në formë të kartmonedhave të madhësisë së dollarit amerikan si dhe katër dokumente me mbishkrimin “Western Union”, tërheqje parash, “Money Gram”, “Pro Credit Bank” në emër të të dënuarit N.A., nga të cilat rezulton se i dënuari kishte pranuar të holla në shuma të ndryshme prej 2.500 – 1.500 € nga Siria nga një sirian i quajtur E.A., po ashtu në profilin në facebook të dënuarit H.E., është gjetur një postim i tij të një personi me armë dhe dy foto të tjera me thënie arabe dhe në sfond me foton e O.B.L.. Nuk është kontestues fakti se sipas Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të OKB-së nr.1822 (2008) Organizata që njihet si shtet islamik i Shamit dhe Levantit (ISIS) është shpallur si organizatë terroriste. Po ashtu, nga një shkresë tjetër të OKB-së SC/11019 rezulton se Fronti “Al-Nusra” është një nga grupet më të afërta terroriste që ndërlidhet me “Al Qaida” e që vepron në territorin e Sirisë e cila po ashtu është shpallur si organizatë terroriste nga OKB-ja në muajin janar të vitit 2012 sipas Rezolutës SC/11019. Mirëpo, se qëllimi i shkuarjes së të dënuarve në Siri ishte bashkëngjitja me këto grupe terroriste dhe aktivitetet e tyre gjykata ka vërtetuar në mënyrë të padyshimtë për çfarë ka dhënë arsye të duhura në aktgjykimin e saj duke theksuar se qëllimi i shkuarjes së tyre ishte pikërisht që t’u bashkëngjiten këtyre organizatave terroriste e jo frontit çlirimtar siç janë mbrojtur të gjithë të dënuarit. Kjo për arsye siç e arsyeton edhe gjykata e shkallës së parë se të gjithë të dënuarit, kanë përfunduar në këto formacione respektivisht në formacionin “Al-Nusra”. Nuk ka qenë kontestues as fakti se i dënuari A.B., ka pohuar se është takuar personalisht me L. M., i cili ishte udhëheqës i shqiptarëve në këtë formacion. Ky i dënuar po ashtu ka pohuar se pasaporta e tij kur i është bashkangjitur këtij formacioni terrorist i është marrë e më pas para se të nisët për në Kosovë, i është kthyer nga R.H., i cili sipas shkresave të çështjes ka qenë ideator, financues, motivues dhe shtytës i shkuarjes në Siri. Për të gjitha këto gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të plota në aktgjykimin e saj.

Nga aktgjykimet e kundërshtuara dhe shkresat e çështjes rezulton se i dënuari N., ka qenë imam në xhamin e fshatit R., komuna e R., ku ka ushtruar rite fetare në kundërshtim dhe pa pëlqimin e BIK-ut dhe se ai ka qenë në kamp ushtrimesh. Ky i dënuar, të dënuarit I.R., e kishte propozuar dhe e kishte marrë me vete që së bashku të shkojnë në Siri siç ka pohuar në polici se me I. kanë hyrë ilegalisht nga Jordania në Siri,

kanë shkuar në qytetin e Taffes dhe siç shprehet “kanë rënë” në grupin “Al-Nusra” dhe të nesërmen i kanë dërguar në kamp për ushtrime. Pra të gjitha këto faktet tregojnë afinitetin e tyre ndaj këtyre formacioneve terroriste dhe se qëllimi i tyre ishte lufta për shtetin musliman e jo ndihma e popullatës siriane siç drejt ka vlerësuar gjykata e shkallës së parë duke dhënë arsyetim se po të ishte qëllimi që këta të dënuarit t’u shkojnë në ndihmë popullatës civile, atëherë do të bashkëngjiteshin ndonjë organizate humanitare e jo organizatave terroriste siç edhe ka ndodhur në rastin konkret, madje asnjëri nuk e ka mohuar këtë fakt që kanë përfunduar në formacionet e “Al-Nusrës”, ndërsa disa prej tyre respektivisht A.B., personalisht është takuar me L.M.. E tërë kjo, nuk mund të interpretohet si rastësi por përkundrazi si qëllimi-dashja për të marrë pjesë në aktivitetet e këtij grupi terrorist.

Nuk është i bazuar pretendimi i mbrojtësit të të dënuarit N.A. se aktgjykimi bazohet në prova të papranueshme respektivisht në provat e gjetura dhe të sekuestruara nga shtëpia e të dënuarit. Në fakt mbrojtësi me këtë pretendim siç rezultojnë nga përmbajtja e kërkesës, nuk e konteston ligjshmërinë e marrjes së këtyre provave dhe nuk jep ndonjë arsyetim se në çfarë kuptimi këto prova konsiderohen të papranueshme. Megjithatë, për tu konsideruar këto prova si të papranueshme ato duhet të sigurohen në mënyrë të kundërligjshme dhe si rrjedhojë dispozita e nenit 111 të KPPK, ka përcaktuar rastet se kur provat e siguruar me anë të kontrollit janë të papranueshme e që në rastin konkret nuk qëndron.

Pretendimi tjetër i mbrojtësit të të dënuarit N., ka të bëjë me atë se gjykata e shkallës së parë ka refuzuar që të nxjerr si provë vërtetimin e Kryqit të Kuq Ndërkombëtar e cila provë vërteton se i dënuari ishte arrestuar nga autoritetet Jordaneze me 08.02.2013 mirëpo, në kërkesë nuk precizohet nëse gjykata nuk ka dhënë arsye lidhur me këtë propozim gjë që do të mund të konsiderohej si shkelje esenciale. Kjo gjykatë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka refuzuar këtë propozim të mbrojtjes sepse fakti se i dënuari ishte i arrestuar nga autoritetet Jordaneze dhe se është bërë vizita nga Organizata e cekur, nuk ka qenë kontestues kështu që përmbajtja e kësaj shkrese nuk ka ndonjë relevancë dhe nuk mund të ndryshojë pozitën juridiko penale të dënuarit në këtë çështje penale.

Nga aktgjykimi i shkallës së parë-arsyet e dhëna në faqen 29 rezultojnë se ISIS dhe “Al-Nusra” janë shpallur si organizata terroriste nga Kombet e Bashkuara në janar të vitit 2012 respektivisht më 30 maj 2013. Aktivitetet e këtyre organizatave kanë ekzistuar edhe më parë, për çfarë është dhënë shpjegimi në këtë pjesë të aktgjykimit të cilat si të drejta i pranon edhe kjo gjykatë meqë aktivitetet e këtyre organizatave terroriste janë zhvilluar në kohën inkriminuese siç është cekur në dispozitiv të aktgjykimit.

Në kontekst të arsytimit të dhënë më sipër, kjo gjykatë nuk e pranon pretendimin e mbrojtësit të të dënuarit N., se Rezolutat e OKB janë prova të

papranueshme sepse nuk janë ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, meqë dokumentet në fjalë janë zyrtare, nuk ka nevojë që të ratifikohen, janë të pranueshme dhe në rastin konkret provat në fjalë, nuk ka pasur pengesë ligjore që të lexohen në shqyrtim gjyqësor. Për të gjitha këto në aktgjykimin e shkallës së parë janë dhëne arsye të duhura ligjore.

Për sa i përket vërtetimit-shkresës së bashkëngjitur me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit N.A., kjo gjykatë vlerëson se një shkresë e këtillë nuk ka ndonjë peshë provuese, meqë nuk dihet origjina e saj, prandaj kjo provë në mbështetje të dispozitës së nenit 259 të KPPK konsiderohet qartazi e parëndësishme meqë edhe pse sipas shkresës është lëshuar nga Komanda e Përgjithshme të Ushtrisë Islame më datë 03.08.2017 nuk ka ndonjë element tjetër që e identifikon origjinalitetin e saj.

Pretendimi i të dënuarit A.B., se është shkelur parimi i barazisë së palëve në procedurë sepse gjykata nuk ka aprovuar propozimin e tij për dëgjimin e dëshmitarëve-zyrtarëve policor që e kanë intervistuar, kjo gjykatë e refuzoi si të pabazuar për faktin sepse drejtë ka vendosur gjykata e shkallës së parë kur këtë propozim e ka refuzuar, për çfarë në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor më 14.12.2015 ka dhënë arsye. Kjo gjykatë vlerëson, siç drejt ka konkluduar gjykata e shkallës së parë, se nuk është i nevojshëm dëgjimi i tyre meqë dëshmitarët e propozuar, si personat zyrtar kanë intervistuar të dënuarin në rrethanat e veprës penale, kurse sa i përket pohimit të tij se të njëjtit i është premtuar se ai nuk do të përfshihet në aktakuzë del si i pabazuar sepse siç rezulton nga shkresat e çështjes, ky i dënuar në këtë çështje penale, nuk është shpallur dëshmitar bashkëpunues siç kërkohet me dispozitën e nenit 236 të KPPK, prandaj nuk është shkelur parimi i barazisë së palëve në procedurë.

Propozimin e mbrojtësit të të dënuarit Ibrahim R., se është shkelur dispozita e nenit 123 par.2 të KPPK, meqë prova e siguruar gjatë marrjes në pyetje në procedurë paraprake, nuk mund të përdoret si provë e drejt për drejtë në shqyrtimin gjyqësor, kjo gjykatë e vlerëson si të pabazuar sepse dispozita ligjore në të cilën thirret mbrojtësi, ka të bëjë me përdorimin e deklaratës së dëshmitarit nga procedura paraprake, në shqyrtim gjyqësor, ndërsa mbrojtësi në kërkesë i referohet deklaratës së të dënuarit N.A. siç theksohet “se është provë e vetme fajësuese meqë i dënuari N. në shqyrtim ka ndryshuar deklaratën”.

Një pretendim tjetër i mbrojtësit të të dënuarit H.E., ka të bëjë me atë se gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë arsye se si ajo vërtetoi faktin se i dënuari ka marrë pjesë në aktivitetet e organizatës terroriste meqë i dënuari ka mohuar një gjë të tillë. Po ashtu pretendimet nga kërkesa e mbrojtësve të të dënuarve të tjerë, si dhe të dënuarit A.B., në pjesën dërmuese i referohen gjendjes së fakteve, për çfarë kjo gjykatë nuk i aprovoj meqë në pajtim me nenin 432 par.2 të KPPK për këtë bazë ligjore, nuk mund të ushtrohet ky mjet i jashtëzakonshëm juridik. Për më tepër të dy gjykatat në

veçanti ajo e shkallës së dytë për këto pretendime ka dhënë arsye ligjore siç është paraqitur në faqen 10 dhe 11 të aktgjykimit.

Pjesa tjetër e kërkesave për mbrojtjen e ligjshmërisë të gjithë mbrojtësve të të dënuarve si dhe të dënuarit A.B., kanë të bëjnë me shkeljen e ligjit penal. Në kërkesat e tyre potencohet se për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vlerësimit të gabuar të provave është shkelur ligji penal në dëm të dënuarve. Të gjithë potencojnë se me asnjë provë nuk është vërtetuar ekzistimi i veprave të kryera penale, se në veprimet e tyre nuk sajohen elementet e kësaj vepre penale meqë qëllimi i shkuarjes së tyre në Siri ka qenë që të ndihmohet popullata siriane e jo bashkëngjitja në veprimtarinë e organizatave terroriste.

Gjykata Supreme edhe këtë pretendim të mbrojtësve e refuzoi si të pabazuar meqë pretendimet në fjalë janë paraqitur edhe në ankesat kundër aktgjykimit të shkallës së parë për çfarë gjykata e shkallës së dytë, ka dhënë arsye të plota lidhur me këtë pretendim të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Përfundimet e të dy gjykatave rreth fajësisë së të dënuarve dhe cilësimit juridik të veprave penale, janë të drejta meqë janë rezultat i vlerësimit të drejtë të provave të administruara në shqyrtimin gjyqësor. Nga deklaratat e të dënuarve del se ata kanë qenë në Siri, se kanë pasur kontaktet me personat të caktuar në Turqi e më pas edhe në Siri nga shumica e tyre, pastaj kalimi ilegal i kufirit, bashkimi me formacionin terrorist “Al-Nusra”, si dhe provave tjera të cilat ishin jo kontestuese, tregon se rrjedhja e ngjarjeve dhe bashkimi i tyre me këto organizata, nuk ka qenë vetëm një rastësi por përkundrazi, qartë tregon se të gjithë mirë kanë ditë se ku po shkojnë, se atje do të bashkëngjiten formacioneve terroriste në rastin konkret “Al Nusra” e me qëllim të luftës për shtetin islamik “Isis”, meqë të gjithë kanë ditur mirë situatën në Siri dhe për zhvillimin e ngjarjeve atje prandaj, kohëzgjatja e qëndrimit në këto organizatat-formacionet siç pretendon i dënuari A. se ka qëndruar vetëm ca ditë, është irelevante për faktin se sipas përkufizimit ligjor të veprës penale organizimi dhe pjesëmarrja në grupet terroriste nga neni 143 par.2 të KPK, është kushdo që merr pjesë në veprimtaritë e grupit terrorist, pra, vepra penale konsumohet në marrjen pjesë në grupet e këtylla pavarësisht kohëzgjatjes së qëndrimit të tyre në grupet në fjalë.

Në kontekst të arsyetimit të dhënë më sipër, është pretendimi i mbrojtësit të të dënuarit I.R., se në rastin konkret i dënuari duhet të përgjigjej për veprën penale nëse merr pjesë në një konflikt lufte jashtë Kosovës pas datës 25.03.2015, kur edhe është dekretuar Ligji për Ndalimin e Bashkimit në Konfliktet e Armatosur jashtë territorit të Kosovës, prandaj është shkelur ligji penal meqë koha inkriminuese në këtë rast ka qenë para nxjerrjes së këtij ligji. Këtë pretendim gjykata Supreme, vlerëson të pabazuar për faktin se të dënuarit në rastin konkret janë shpallur fajtor për shkak të veprës penale nga neni 143 par.2 të KPK, sipas të cilës dispozitë për ekzistimin e kësaj vepre penale vendi i veprimtarisë inkriminuese, nuk është relevant por, siç u tha më lart pjesëmarrja

në veprimtarinë e grupit terrorist, gjë që në rastin konkret është vërtetuar kurse sa i përket ligjit në të cilin thirret mbrojtësi në kërkesën e tij, këtu kemi të bëjmë me një ligj të veçantë për pjesëmarrjen e qytetarëve të Kosovës në veprimtaritë terroriste jashtë shtetit të Kosovës.

Nga arsyet e lartcekura kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë janë refuzuar si të pabazuara dhe në pajtim me dispozitën e nenit 437 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË
PML.nr.225/2017, datë 18 dhjetor 2017

Procesmbajtësi,
Bujar Balaj

Kryetar i kolegjit,
Enver Peci